

## K O N T R A T E

### I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROFARMA TQ TOLICA"

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE,  
KOHEZGJATJA

Ne baze te ligjit nr.7512, date 10.8.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe nenit 64 te ligjit 7667 date 28.1.1993 per regjistrimin e shoqerive ne regjistrin tregtar me vullnetin e tyre te lire te shprehur ne nenshkrimin e kesaj kontrate ortaket ;

Z.Toni Tolica, i biri i Margos dhe i Sofise, dtl.1944, banues ne Tirane, rruga "Kavajes" nr.122/ 1

Z.Qirjako Tolica, i biri i Margos dhe i Sofise dtl. 1953, banues ne Tirane,  
te cilet kane krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "EUROFARMA TQ TOLICA" SH.P.K.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EUROFARMA TQ TOLICA" eshte :  
- Tregtim te artikujve parafarmaceutike, blerjen dhe shitjen e medikamente, marrja me qira dhe ngritja e lokaleve per tregtim, depozitimin ose manipulimin e medikamenteve dhe te mallrave te tjera industriale.

#### SELIA E SHOQERISE

Selia e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "EUROFARMA TQ TOLICA" eshte ne rrugen e Kavajes nr.122/1, Tirane.

#### KOHEZGJATJA

Jetegjatesia e Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar EUROFARMA TQ TOPLICA sh.p.k. eshte mbi 10 vjet.

#### KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT OSE PJESET

Kapitali themeltar i shoqerise TIRANA sh.p.k. eshte 100.000 LEKE.

S T A T U T I  
I SHOQËRISË " EUROFORMA T-Q TOLICA SH P K "

Tiranë, më 1.1.1994

Ortakët :

I. TONI TOLICA

i biri i Margos dhe i Sofisë i dt.1944 me letërnjoftimin nr. EV 219979

II. QIRJAKO TOLICA

i biri i Morgos dhe i Sofisë, i dt.1953, me letërnjoftimin nr. \_\_\_\_\_.

Sipas dëshirës së plotë të tyre, u morën vesh:

Neni 1

Të krijojnë një shoqëri tregtare të përbashkët, të emëruar "EUROFORMA E-Q Tolica SHPK", me seli në Tiranë. Në marrëdhënie me të tjerët shoqëria mund të paraqitet vetëm me emrin e mësipërm.

Neni 2

Shoqëria tregtare "EUROFORMA T Q Tolica" SH P K është person juridik shqiptar dhe vepron sipas ligjeve në fuqi.

Shoqëriq e përbashkët "EUROFORMA T Q TOLICA" SH P K fiton të drejtën e personit juridik pas miratimit nga organet gjyqësorë dhe pas regjistrimit në organet financiare.

Neni 3

Objekti i krijimit të shoqërisë së përbashkët tregtare "EUROFORMA T Q TOLICA SH P K" është: Importimi ose blerja brenda vendit dhe shitja në Shqipëri e medikamenteve dhe e mallrave të tregtisë industriale, marrja me qira ose ngritja e lokaleve për tregtimin, distributimin ose manipulimin e medikamenteve dhe e mallrave të tjera industriale, si dhe krijimi i lidhjeve me shoqëri të tjera tregtare shqiptare.

re të njohura si person juridik ose fizikë, sipas legjislacionit në fuqi, për të realizuar veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë caktohet për një periudhë <sup>(në 10 vjetra)</sup> vjeçare, me të drejtë ripërtëritje në marrëveshje të ortakëve.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë caktohet në 100.000 Lekë.

Kontributi i ortakëve në kapital është.

I. Kontributi në natyrë:

Toni Tolica — lekë

Qirjako Tolica — "

II. Kontributi në para:

Tohi Tolica 50000 lekë

Qirjako Tolica 50000 lekë

III. Kontributi i bashkuar:

Toni Tolica 50000 lekë, baraz me 50 % të kapitalit

Qirjako Tolica 50000 " ; baraz me 50 % "

Me vendim të mbledhjes së përgjithshme të ortakëve kapitalistë fillestar i themelimit mund të rritet, me kontributin e të dy ortakëve ose të njërit prej tyre.

Neni 6

E drejta e votës të çdo ortaku në Mbledhjen e Përgjithshme është në raport të drejtë me kontributin e tij në kapitalin themel. Çdo njeri prej ortakëve ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat që i takojnë shoqërisë, duke marrë përsipër përgjegjësinë që rrjedh prej veprimeve të tij dhe që parashikohen në legjislacionin shqiptar.

tar për shoqëritë tregtare me përgjegjësi të kufizuar(SHPK)

### Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë së përbashkët tregtare "EUROFORMA T Q TOLICA SH P K" janë:

1. Mbledhja e Përgjithshme(Asambleja) e ortakëve.
2. Administratori i vetëm(Presidenti)

### Neni 8

Mbledhja e Përgjithshme e ortakëve është organi më i lartë i shoqërisë" EUROFORMA T Q TOLICA SH P K". Ajo ka të drejtë të vendosi për çdo problem që i përket kësaj shoqërie.

Vendimet e ligjshme të kësaj shoqërie janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë ortakët, përfshirë edhe ata që kanë votuar kundër në marrjen e tyre.

Mbledhja e Përgjithshme e ortakëve bëhet në vendin ku është selia e shoqërisë, jo më rrallë se një herë në vit gjatë kohëzgjatjes së shoqërisë dhe brenda 6 muajve nga data e mbarimit të afatit të kohëzgjatjes së shoqërisë.

Administratori i vetëm ( Presidenti) ka të drejtë të thërrasiedhe mbledhjen e jashtëzakonshme të Asamblesë.

Për mbledhjen e Përgjithshme ortakët njoftohen të paktën 15 ditë përpara , duke u komunikuar me shkrim datën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

### Neni 9

Në mbledhjen e parë të Asamblesë , kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të votojnë vetëm ortakët të cilët kanë depozituar pjesën e tyre të kapitalit në natyrë në favor të shoqërisë ose para në arkën e shoqërisë apo në llogarinë përkatëse në Bankë, të paktën 5 ditë përpara mbledhjes.

Ortakët kanë të drejtë të përfaqësohen në mbledhje nga persona të paisur me prokurë të posaçëm prej tyre.

Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme të ortakëve (Asamble së) merren me shumicë votash.

Neni 10.

Mbledhjen e Përgjithshme të ortakëve e drejton Administratori i vetëm (Presidenti) i Shoqërisë "EUROFORMA TQ TOLICA SHPK". Detyrën e sekretarit të mbledhjes e kryen një person që caktohet nga Presidenti.

Diskutimet dhe vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme kufizohen në çështjet që përfshihen në rendin e ditës dhe pasqyrohen në një libër të veçantë, duke u nënshkruar nga Presidenti dhe sekretari.

Neni 11

Mbledhja e Përgjithshme e ortakëve (Asambleja) ka këto kompetenca ekskluzive.

a) Të bëjë shtesa dhe ndryshime në përmbajtjen e statutit


b) Të shtojë ose pakësojë kapitalin e shoqërisë së përbashkët.

c) Të zgjedhë Administratorin e vetëm (Presidentin).

ç) Të përcaktojë formën e shpërndarjes së fitimeve në fund të çdo viti ekonomik financiar.

d) Të vendosë shpërndarjen, thithjen ose bashkimin e shoqërisë.

Neni 12

  
Administratori  
Presidenti

Administratori është drejtuesi i shoqërisë së përbashkët tregtare dhe mbetet i zgjedhur deri në zgjedhjen e mundshme

të një Këshilli Administrativ, krahas zgjerimit të veprimtarisë së Shoqërisë së përbashkët, për jo më shumë se tre vjet.

Neni 13

*[Signature]*  
Administratori

~~Presidenti~~ merr masa përorganizimin dhe drejtimin e punës së shoqërisë së përbashkët tregtare që kanë lidhje me arritjen e objektivave të saj të caktuara në nenin 3 të statutit.

Administrojnë nga pikëpamja ekonomike e financiare pasurinë e shoqërisë së përbashkët tregtare, jep urdhëra e udhëzime për zbatim nga personat punëmarrës në shoqërinë "EUROFARMA TQ TOLICA SH P K", në përputhje me këtë statut, me vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme dhe me legjislacionin në fuqi.

*[Signature]*  
Administratori

Neni 14

~~Presidenti~~ përgjigjet para shoqërisë për të gjitha pasojat që vijnë nga veprimet ose mosveprimet e kryera prej tij gjat drejtimit të shoqërisë së përbashkët tregtare dhe trajtimit të problemeve të saj.

Neni 15

Në fund të çdo viti ekonomiko - financiar, ~~Presidenti~~ verifikon mbylljen e llogarive dhe regjistrimin e detajuar të pasurisë së shoqërisë së përbashkët dhe firmos bilancin e relacionin shoqëror për aktivitetin e shoqërisë, për ta kaluar për miratim në Mbledhjen e Përgjithshme të Ortakëve.

*[Signature]*  
Administratori

~~Presidenti~~ miraton plan - biznesin së bashku me relacionin shkëqitës për veprimtarinë e shoqërisë në vitin e ardhshëm.

Neni 16

Fitimi neto i shoqërisë së përbashkët del, pasi të zbriten nga të ardhurat e saj, të gjitha shpenzimet që janë bërë gjatë vitit kalenderik dhe pasi të jenë paguar taksat, tatimet dhe

tyrimet e tjera të shoqërisë ndaj shtetit , sipas ligjeve në fuqi.

Neni 17

Ortakët shprehin vullnetin e tyre të mirë se do të punojnë me predispozicion për realizimin e objektivave ekonomike e financiare të shoqërisë bazë mirëkuptimit reciprok dhe në përputhje me ligjet dhe statutin e shoqërisë së përbashkët tregtare " EUROFARMA T Q TOLICA SHPK".

Mosmarrëveshjet do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në pamundësi me anë të gjykatës.

Toni Tolica



Qirjako Tolica

